

VENDIM
Nr. 75, datë 19.3.2021

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR.
34, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘HERA’ SHPK, PËR SHTYRJEN
E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 2.11.2007, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67 dhe të nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/3 prot., datë 17.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe propozimin e Këshilltares së Bordit të ERE-s, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 34, datë 4.2.2021, vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., nr. 49, seria NPM07P.

3 Shoqëria “HERA” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimarrje të Bordit të ERE-s nëpërmjet shkresës nr. 300 prot., datë 13.2.2021, përmes së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme, me shkrim, nga marrja e kësaj shkrese.

- Brenda afatit 30 ditor, brenda të cilit shoqërisë i jepet e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 300/1 prot., datë 17.2.2021, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimarrjes së Bordit, me qëllim që t’i jepet mundësia shoqërisë të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për sa pretenduar nga ajo në kuadër të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit nr. 34/2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021.

2. Shoqëria “HERA” sh.p.k., brenda 10 ditëve punë, të dokumentojë në ERE sa pretenduar në shkresën nr. 300/1 prot., datë 17.2.2021.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojnë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti